



	Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS SUDSKI SAVET KOSOVA KOSOVO JUDICIAL COUNCIL	
Nr.Br.No.	01, 896
DAT.DT.	17.11.2021
PRISHTINE - A	

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI JURIDIK
PRISHTINË

Pranuar me:	17.11.2021		
Nr. org.	Numër	Sasia	Vlera
02	78		



Këshilli Gjyqësor i Kosovës
Sudski Savet Kosova
Judical Council Kosovo

Universiteti i Prishtinës
Fakulteti Juridik

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

në mes

KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

dhe

FAKULTETIT JURIDIK - UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS

Prishtinë, 01 nëntor 2021

Palët kanë arritur pajtim dhe mirëkuptimin për çështjet vijuese, që pasqyrohen në nenet e këtij memorandumi:

**Neni 1
Qëllimi**

1.1. Qëllimi i këtij memorandumi është krijimi i bashkëpunimit në mes të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK-së) dhe Fakultetit Juridik/Universitetit të Prishtinës (tutje referuar si “FJ UP” dhe “Fakulteti Juridik”) për lehtësimin e dhënies së ekspertizës së personelit akademik të Fakultetit Juridik-UP për KGJK-në, praktikës profesionale të studentëve të Fakultetit Juridik, angazhimin e gjyqtarëve apo anëtarëve të KGJK në aktivitete akademike të përbashkëta, kur kjo vlerësohet e mundshme nga palët, si dhe ndihmën në rritjen e transparencës së gjyqësorit në Kosovë përmes platformave që synojnë informimin e publikut dhe qytetarëve.

1.2. Bashkëpunimi i palëve përmes këtij memorandumi, ndër të tjera, ka si qëllim të rëndësishëm që të ndërmerren hapat e nevojshëm për miratimin, përditësimin dhe fuqizimin e platformës “www.gjykataime.org”, që do t'u shërbej qytetarëve të marrin informacione të nevojshme për gjykatën, procedurat gjyqësore, lëndët në gjykim dhe informata të tjera relevante për gjyqësorin.

**Neni 2
Fushëveprimi**

Ky memorandum përfshin të drejta dhe obligime reciproke, për palët nënshkruese dhe zbatohet në kuadër të të drejtave dhe obligimeve që marrin palët, duke pasur parasysh qëllimin e tij.

**Neni 3
Të drejtat dhe detyrimet e palëve**

- 3.1. Palët pajtohen që të drejtat dhe detyrimet të përcaktohen në përmbajtjen e këtij memorandumi.
- 3.2. Në rast të dallimeve, palët pajtohen që të zgjidhin dallimet në bazë të mirëkuptimit, përfshirë edhe zgjidhjen që favorizon mundësinë që platforma të jetë funksionale dhe e përditësuar.

**Neni 4
Përgjegjësitet dhe objekti i memorandumit**

- 4.1 Palët pajtohen që personeli akademik i Fakultetit Juridik, në bazë të një komunikimi dhe pajtimi paraprak me shkrim (përfshirë komunikimin me e-mail), në varësi të mundësive dhe kapaciteteve që posedon fakulteti, të angazhohen në lehtësimin e dhënies së ekspertizës profesionale, për çështjet si në vijim:

- a) Në fushën e hartimit/ndryshimit/analizës së legjislacionit primar që prek sistemin gjyqësor, dhe që procedohet për miratim nga Ministritë relevante, Qeveria, dhe në Komisionet parlamentare dhe Kuvend.
- b) Në fushën e hartimit/ndryshimit/analizës së legjislacionit sekondar, sipas nevojave dhe vlerësimit të KGJK-së.
- c) Ofrimin e opinioneve profesionale dhe vlerësimeve shkencore, për interes të KGJK-së, për shqyrtim nga anëtarët e komisioneve të KGJK-së, komisioneve parlamentare, grupeve punuese në nivel të ministrike dhe qeveritare dhe deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, me qëllim të forcimit të arsyeshmërisë, standardit, pavarësisë së gjyqësorit, dhe/apo sigurisë së zbatimit të legjislacionit.
- d) Ofrimin e njohurive dhe ekspertizës profesionale, për çështje të tjera të cilat bien në fushëveprimin dhe kompetencat e KGJK-së, duke mos përjashtuar, hartimin e akteve të brendshme e dokumenteve strategjike të KGJK-së, trajnimeve, pa përjashtuar çështje tjera që KGJK konsideron të nevojshme, në kuadër të politikave dhe planit vjetor të punës.
- e) Zhvillimin e konsultimeve dhe takimeve periodike me anëtarët e KGJK-së dhe komisionet përkatëse, me qëllim të ofrimit të mbështetjes dhe ekspertizës profesionale.
- f) Organizimin e konferencës së përbashkët vjetore, ku anëtarët e KGJK-së dhe personeli akademik i Fakultetit Juridik - UP diskutojnë dhe trajtojnë çështje të ndryshme\relevante për të dyja palët, të ndërlidhura me sistemin e drejtësisë.
- g) Mundësimin e praktikës profesionale për studentët e Fakultetit Juridik-UP në KGJK dhe gjykata sipas mundësive ekzistuese dhe planifikimeve paraprake, përfshirë punë praktike pa pagesë apo edhe programet e ndryshme që mund të financohen nga partnerë të ndryshëm të Fakultetit Juridik apo KGJK-së.
- h) Mundësimi i praktikës profesionale sipas pikës g, si me sipër, përfshinë edhe praktikën në KGJK dhe gjykata për studentët e huaj që vijnë në programet e mobilitetit në koordinim me Fakultetin Juridik - UP.

4.2. Palët pajtohen që në bazë të një komunikimi dhe pajtimi paraprak me shkrim (përfshirë komunikimin me e-mail) KGJK, në varësi të mundësive dhe kapaciteteve që posidon tu ofrojë personel dhe ekspertizë profesionale për nevojat e Fakultetit Juridik-UP në fushat sikurse në vijim:

- a) Të ofrojë gjyqtarë me ekspertizë profesionale relevante për mësimdhënie dhe aktivitete akademike të përbashkëta në lëndët klinike dhe në lëndët tjera mësimore;
- b) Anëtarët e KGJK apo gjyqtarët të marrin pjesë në hartimin e kurrikulave mësimore për të gjitha nivelet e studimit që ofron njësia akademike;
- c) Anëtarët e KGJK apo gjyqtarët të marrin pjesë në hartimin e dokumenteve strategjike.

4.3. Palët pajtohen që ndihma të konsistojë në një ekspertizë që përmban aspekte shkencore, praktike dhe/ose metodologjike e të cilat i japin një vlerë të shtuar profesionale, punës vlerësuese të projektligjeve e akteve tjera juridike, nga ana e anëtarëve të KGJK-së, komisioneve apo vet Kryesuesit/Kabinetit të Kryesuesit të KGJK-së.

4.4. Fakulteti Juridik i UP-së, merr përsipër detyrimin që, sa herë që kërcohët dhënia e ekspertizës për një draft-akt apo çështje tjetër, të caktuar, t'i ofroj KGJK-së dhe komisioneve, së paku një ekspert të fushës së ngushtë profesionale, i/e cili gjëzon kredibilitet e profesionalizëm, për të dhënë një ekspertizë të tillë. Konsulenti/ët propozohen nga radhët e personelit akademik të Fakultetit.

4.5. Kryesuesi i KGJK-së merr përsipër që të udhëzoj administratën e KGJK-së, dhe kryetarët e komisioneve, që të kërkojnë nga Fakulteti Juridik i UP-së që të propozojnë anëtar nga radha e personelit akademik, për dhënie ekspertize, sa herë që ata kanë nevojë për një gjë të tillë, dhe në raste të tillë, të kontaktojnë me përfaqësuesin e Fakultetit Juridik, të përcaktuar sipas këtij memorandumi, për të kërkuar ekspert/e të caktuar.

4.6. Përfaqësuesi i Fakultetit Juridik (Dekani), në koordinim me përfaqësuesin e KGJK-së (Kryesuesi), do të mbaj takime informuese me kryetarët e komisioneve dhe KGJK-në, brenda një periudhe gjashtë (6) mujore, nga nënshkrimi i këtij Memorandumi për t'i diskutuar mundësitë praktike dhe fushat ku mund të ofrohet ekspertiza si të realizohet objekti i këtij memorandumi duke pasur parasysh nevojat e KGJK-së.

4.7. Fakulteti Juridik merr përsipër që, sa herë që kërcohët ndihma profesionale e personelit akademik, t'i përgjigjet KGJK-së në kohën më të shkurtër të mundshme.

4.8. Fakulteti Juridik gjithashtu merr përsipër që t'i përbahet rregullave etike e ligjore që garantojnë konfidencialitetin e punës profesionale, mbi të cilat bazohet veprimtaria e KGJK-së, dhe të ushtroj funksionin propozues të ekspertëve, mbi baza të barazisë gjinore.

4.9 Zbatimi i pikave 4.4 deri 4.8 bazohet në një komunikim dhe pajtim paraprak me shkrim (përfshirë komunikimin me e-mail) midis palëve dhe në varësi të mundësive dhe kapaciteteve që posedon secila nga palët.

4.10. KGJK merr obligimin që të angazhohet, të mundësoj, dhe të lehtësoj shkëmbimin e informacioneve që janë në posedim të Këshillit dhe gjykatave, dhe të cilat shërbejnë për www.gjykataime.org/, në bazë të kërkesës së Fakultetit Juridik, apo me vet iniciativë, në rastet kur Këshilli e vlerëson të nevojshme përditësimin e informacionit të paraqitur më herët në platformë “www.gjykataime.org/”.

4.11. Pavarësisht paragrafit 4.10 të këtij nenit, informacionet e nevojshme që duhet të shkëmbohen dhe/ose t'i dërgohen Fakultetit Juridik, në baza të rregullta, përfshijnë por nuk kufizohen në:

- a) të dhëna statistikore në lidhje me lëndët e regjistruarë në gjykatë dhe lëndëve të kryera për periudhën e kërkuar (çdo gjashtë muaj);
- b) informata të gjykatave, nëse ato ndryshohen apo plotësohen në të ardhmen dhe të cilat janë të paraqitura në www.gjykataime.org/;
- c) informata/të dhëna të tjera të nevojshme për publikun;

- d) të kërkoj nga gjykatat e të gjitha niveleve të ofrojnë bashkëpunim me qëllim të realizimit të këtij Memorandumi;
- e) të kryej veprime të tjera të cilat i vlerëson të nevojshme për realizimin e qëllimit të këtij bashkëpunimi;

4.12. Për të realizuar obligimet e përcaktuara në paragrafët 4.6 dhe 4.7.të këtij nenit, Fakulteti Juridik merr përsipër obligimet e mëposhtme:

- a) të zgjedh, mbi bazë të kriterit të meritës, së paku dy (2) studentë që do të jenë përgjegjës për mirëmbajtjen dhe përditësimin e informacionit në platformën www.gjykataime.org/, në pajtim edhe me marrëveshjen e datës
- b) të mirëmbajë dhe përditësoj informacionin që ofrohet nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe gjykatat në platformën "www.gjykataime.org/", duke siguruar që informacioni që është zyrtar dhe u përket gjykatave është konfirmuar nga Këshilli para publikimit;
- c) në baza gjashtë (6) mujore të përditësoj të dhënat në "Trend Analysis Dashboard" sipas të dhënavë që i dërgon KGJK. Fakulteti, merr përgjegjësinë që të kërkoj në baza të rregullta këto të dhëna nga KGJK;
- d) të identifikoj dhe përmirësoj gabime apo të plotësoj zbrazëtira në platformë sipas bashkëpunimit me palët e treta apo punës së brendshme të Fakultetit;
- e) të siguroj gjatë gjithë kohës së vlefshmërisë së këtij Memorandumi dhe pas, mirëmbajtjen e çfarëdo informacioni që merret nga Këshillidhe palët e treta dhe që është paraqitur në [www.gjykataime.org.](http://www.gjykataime.org/)

Neni 5 Mirëbesimi

Palët pajtohen që ky memorandum zbatohet në mirëbesim profesional, duke realizuar obligimet konkrete të këtij memorandumi.

Neni 6 Kompensimi

Memorandumi i Bashkëpunimit nuk krijon detyrime financiare në mes palëve. Kostot që rrjedhin nga përbushja e zotimeve të përcaktuara nga ky memorandum u ngarkohen palëve, në pajtim me rregullativën në fuqi.

Neni 7 Plotësimet dhe ndryshimet në Memorandum

KGJK dhe Fakulteti Juridik-UP mund të plotësojnë pjesë të këtij Memorandumi në çdo kohë, nëse për to është dhënë pëlgimi me shkrim i KGJK-së dhe Fakultetit Juridik.

Neni 8
Kohëzgjatja e Memorandumit

- 8.1. Memorandumi ka vlefshmëri të pakufizuar, përpos nëse palët merren vesh ndryshe me shkrim.
- 8.2. Memorandumi mund të përfundoj me kërkesën me shkrim nga cilado prej palëve nënshkruese, me një paralajmërim prej së paku 30 ditëve.

Neni 9
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët pajtohen që çfarëdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin e një pjese apo në tërësi të këtij memorandumi, ta zgjidhin me mirëkuptim, në fryshtë e njëjtë me të cilën është nënshkruar ky Memorandum.

Neni 10
Hyrja në fuqi

- 10.1. Ky Memorandum hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij nga palët.
- 10.2. Memorandumi nënshkruhet në 2 kopje të njëjta, nga një kopje për secilën palë.

Palët nënshkruese:

Për: Këshillin Gjyqësor të Kosovës

Albert Zogaj - Kryesues



Për: Fakultetin Juridik-UP


Prof. Ass. Dr. Avni Puka - Dekan